



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT  
DEKANATI

REKTORI

Prof. Dr. Agron CUKA




RREGULLORE  
E ZHVILLIMIT TË KONKURSIT TË PRANIMIT

NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

VITI AKADEMIK 2020-2021

DEKANI

Prof. Asoc. Ferdinand MARA



**RREGULLORE E BRENDSHME**  
**MBI PROCEDURËN E ZHVILLIMIT TË KONKURSIT TË PRANIMIT TË**  
**STUDENTËVE**  
**PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021**

Për të realizuar në praktikë një zhvillim sa më normal të konkursit praktik në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, si dhe për të mbështetur dhe lehtësuar mundësinë e vlerësimit objektiv dhe transparent për secilin kandidat, kërkojmë të zbatohen me rigorozitet sa më të madh kërkesat e rregullores së mëposhtme:

**1. E drejta për konkurim**

Të drejtën për konkurim praktik në UST për vitin akademik 2020-2021 e fitojnë:

- 1.1 Kandidatët e përfshirë në listat e ardhura nga Agjensia Kombëtare e Provimit.
- 1.2 Kandidatët që kanë bërë regjistrimin përfundimtar në Degën e Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST.
- 1.3 Kandidatët janë të detyruar të konkurojnë në dy teste: *kërcim së gjati nga vendi dhe testi kompleks koordinativ (cirkuiti)*. Shumatorja e pikëve të mbledhura në të dy testet (pikë të cilat janë paraqitur sipas ponderimit në tabelën bashkangjitur testeve të pranimit), do të japë nivelin e pikëve të fituara nga konkursi për testin praktik. Këto pikë të mbledhura me pikët e fituara nga mesatarja e shkollës së mesme do të përbëjnë rezultatin total të konkursit me të cilin ai do të përfaqësohet në rreshtimin e gjithë konkuruesve vajza dhe djem *FITUES*.
- 1.4 Konkuruesi do të fitojë 30% të pikëve nga mesatarja e shkollës së mesme dhe 70% të pikëve nga rezultati i dy testeve praktike të zhvilluara në konkurs. **Kandidatët duhet që të grumbullojnë minimum 12 (dymbëdhjetë) pikë nga 70 (shtatëdhjetë) të mundshme të konkurimit praktik.** Duke u nisur nga struktura e testeve që kanë si bazë zhvillimin e përgjithshëm motorrik, është e kuptueshme që seleksionimi i kandidatëve për këtë fakultet, nuk bëhet duke u nisur nga një disiplinë e vecantë. Kjo do të thotë që ky fakultet përgatit trajnerë të fitnesit, animatorë dhe guida turistike si dhe menaxherë të sportit dhe veprimtarive fizike. Në këtë këndvështrim, është gjykuar që testi praktik të ketë vetëm 70% të vlerësimit të përgjithshëm, kurse formimi intelektual (matura shtetërore) të ketë 30% të tij.

## **2. Ngritja e Komisioneve të Konkursit**

- 2.1 Komisioni Qendror i përbërë nga 3 (tre) anëtarë është përgjegjës për të gjithë ecurinë e konkursit.
- 2.2 Rektori i UST merr masa dhe organizon që në strukturat e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit të ngrihet Komisioni i Konkursit të Pranimit i përbërë nga 4 (katër) anëtarë për organizimin dhe mbarëvajtjen e konkursit.
- 2.3 Komisioni i ankimimit (3 veta) nga të cilët kryetari duhet të jetë jurist, shqyrton të gjitha ankimet dhe mosmarrveshjet gjatë zhvillimit të konkursit dhe shprehet me vendimin përkatës në përputhje me Rregulloren e Konkursit të pranimit në UST.

## **3. Procedurat e konkurimit**

- 3.1 Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, shpall listën emërore të konkuresve sipas rendit alfabetik jo më vonë se 24 orë përpara datës së konkurimit për vitin Akademik 2020 – 2021.
- 3.2 Konkurimi praktik fillon në orën 9:00. Paraqitja e konkurentëve bëhet në orën 8:00. Kjo orë sëbashku me datën e konkurimit shpallet jo më vonë se 24 orë përpara ditës së konkurimit në ambientet e UST si dhe në faqen zyrtare elektronike.
- 3.3 **Lejohet të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurim të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë biometrike). Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të lejohen të marrin pjesë në konkurs.**
- 3.4 Përpara konkurimit kandidatëve u komunikohen rregullat e konkursit të pranimit.
- 3.5 Në momentin e regjistrimit, konkuresit i jepet kartela personale e konkurimit në të cilën konkuresit i shënohen rezultatet e arritura në 2 testet praktike (koha në sekonda dhe distance e kercimit në metra).
- 3.6 Rradha e disiplinave konkuresive do të jetë:
  - A. Testi kërcim së gjati nga vendi 2 prova (shënohet rezultati më i mirë).
  - B. Testi-cirkuit, kryhet vetëm një provë pa të drejtë përsëritje.
- 3.7 Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtar. Do të ketë 1 (një) anëtar që komunikon me zë rezultatin dhe 1 (një) që shënon rezultatin e çdo konkuresi në kartelën e tij personale. Shënimi i rezultatit bëhet me stilolaps ngjyrë blu, rezultatin e

pastër pa korrëjrim në fletën zyrtare të konkurimit, pas komunikimit me zë të lartë të këtij rezultati dhe një anëtar tjetër pranë tij hedh këtë rezultat në kartelën personale të kokuruesit duke firmosur ai vete dhe kokuruesi në këtë kartelë.

- 3.8** Në rast të mospërputhjes së nivelit të rezultatit të shënuar në fletën zyrtare dhe në kartelën personale të kokuruesit, personi përgjegjëës do të mbajë përgjegjësi të plotë ligjore.
- 3.9** Rezultatet përfundimtare do të shpallen jo më vonë se 24 orë pas përfundimit të plotë të konkurimit. Rezultatet do të shpallen me ID-ne e kandidatit për të respektuar percaktimet e kuadrit ligor për mbrojtjen e të dhenave personale.
- 3.10** Secili konkurent ka të drejtën e ankimit me shkrim të rezultatit pranë komisionit përkatës të ngritur qëllimisht për shqyrtimin e tërë ankesave duke e dorëzuar atë pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST.
- 3.11** E drejta e ankimit ka afat deri në 72 orë nga shpallja e rezultateve përfundimtare kjo dhe nëse brenda kësaj periudhe 3 ditore qëllonjë ditë e shtunë ose e dielë.
- 3.12** Pas 72 orëve nga shpallja e rezultatit, brenda ditës komisioni i ankimit i paraqet proces-verbalin përkatës me vendimin e formës së prerë në komisionin e pranimeve.
- 3.13** Pas kësaj periudhe, Komisioni Qëndror i konkursit shpall listën përfundimtare të rezultateve të konkursit.
- 3.14** Përvec anetarëve të komisioneve dhe përfaqësuesve të Komisionit Qëndror ose personave të autorizuar prej tij, asnjë i huaj, për asnjë arsye, nuk mund t'i afrohet Komisioneve të Vlerësimit.
- 3.15** Për zhvillimin normal e të qetë të konkursit, lajmërohet Komisariati i Policisë për angazhimin e policisë në tërë objektet ku zhvillohet konkurimi praktik.
- 3.16** Komisioni i konkurimit praktik, ka për detyrë që rezultatet përfundimtare të hedhura në fletën zyrtare t'i memorizojë edhe në formë elektronike. Komisioni, rezultatet përfundimtare me formularët origjinalë dhe në formë elektronike i përcjell pranë Rektoratit.

**DEKANI**

**Prof.Asoc. Ferdinand MARA**